



P Z A P
I P Ž P

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNİ PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.223/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti kryesues, Kujtim Pasuli, dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) me seli në Prishtinë, parashtruar kundër Subjektit Politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë;09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë;30.01.2025, merr këtë,

V E N D I M

I. Pranohet e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, Anr.223/2025, datë;27.01.2025.

II. Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënim i gjelbëri më gjelbëri në lartësi prej 4000.00 (katërmijë) Euro.

III. Detyrohet Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë;23.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Insitituti Demokratik i Kosovës (KDI), me të cilën pretendohet se më datë 27 Janar 2025, rrëth orës 15:00 monitoruesit e organizatës tonë kanë vërejtur një banerë të kandidates së LDK-së znj.Saranda Musliu me nr.81 në rrugën Kadri Zeka në Gjilan, fotografi kjo e vendosur në disa drunjë ndërmjet rrugëve Lulzim Ramadani dhe Kadri Zeka. Ka theksuar se me këtë veprim kandidatja dhe Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës LDK, kanë bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës - LZP. Si provë për pretendimet në ankesë, parashtruesi ka bashkangjitur fotografin e posterit të kandidates Saranda Musliu me nr. 81 të subjektit LDK.

Më datë;28.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për përgjigje në ankesë deri me datë;29.01.2025 në ora 12:00

Në përgjigjen në ankesë të Subjektit Politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), theksohet se kemi të bëjmë me vendosjen e posterit nga kandidatja, Saranda Musliu në një

hapësire, e cila shfrytëzohet nga një Restaurant në Ferizaj, dhe i njëjtë ka dhënë pëlqimin verbal për vendosjen e materialit të tillë zgjedhor.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën vëren se ankesa është e bazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik LDK, vlerësoj se pretendimet e KDI, janë të qëndrueshme dhe si të tillë i aprovoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku përcaktohet se “*Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose ne hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.*”

Në rastin konkret pretendimet ankimore që kanë të bëjnë me kandidaten në fjalë janë të bazuara për shkak se e njëta e ka vendosur posterin në rrugën “Kadri Zeka” në Gjilan fotografi kjo e vendosur në disa drunjë ndërmjet rrugëve “Kadri Zeka” dhe “Lulzim Ramadani”, pa pëlqimin me shkrim të pronarit, ose pëlqimin me shkrim nga organi kompetent, komunal, dhe se veprimet e tillë paneli i konsideron si shkelje të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Paneli vlerësoj se pretendimet e tillë janë të qëndrueshme dhe si të tillë i pranoi, sepse kjo shkelje ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e pranoi si të bazuar.

Pretendimi i subjektit politik LDK në përgjigenët në ankesë se posteri i vendosur nga radhët e LDK është vendosur në një hapësire e cila shfrytëzohet nga një Restaurant në Ferizaj, me pëlqimin verbal të të njëjtët, ky pretendim është i pa bazuar, pasi që në përgjigenët në ankesë, nuk është bashkangjitur asnjë pëlqim nga LDK, dhe nuk është bashkangjitur asnjë leje përkatëse nga organi kompetent për shfrytëzimin e hapësirës publike.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përben përsëritje të shkeljes për nga natyra është i njëjtë apo ngjashëm, subjektit politik që ka bërë shkelje të legjislacionit zgjedhor, apo ka bërë shkelje të legjislacionit edhe në proceset e mëparshme zgjedhore, që konsiston në faktin se subjekti politik LDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nen parafi 1.3 të LZP-së, të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresë

Anr.223/2025, datë;30.01.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së.